

UDHËZUES PËR AUTORËT QË DËSHIROJNË TË BOTOJNË PUNIMET E TYRE NË “AKTET E TAKIMIT VJETOR NDËRKOMBËTAR”

Aktet e Takimit Vjetor Ndërkombëtar boton punime të prezantuara gjatë Takimit Vjetor të Instituti Alb-Shkenca (IASH). Kjo revistë pranon për botim vetëm punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për përparimin e shkencës. Revista drejtohet prej këshillit botues, i cili përbëhet prej një krye-redaktori, një redaktori teknik dhe disa redaktorëve shkencorë përgjegjës për fusha të veçanta të shkencës. Autorët që kanë prezantuar gjatë takimit vjetor të IASH-së mund të dërgojnë punimet e tyre për botim.

Preferohet që dorëshkrimet të paraqiten në gjuhën angleze por mund të jenë edhe në shqip sipas interesit të autoreve. Dërgimi i dorëshkrimit nënkupton që puna e paraqitur në të nuk është botuar më parë (përveç se në formën e një përmbledhjeje, leksioni apo teze akademike), nuk është në shqyrtim për tu botuar gjetkë dhe se botimi është aprovuar nga të gjithë autorët si dhe autoritetet përgjegjëse ku puna është kryer. Autorëve do t’ju kërkohet që të deklarohen në se ka ndonjë konflikt interesash si dhe ndonjë burim financiar të veçantë të përdorur për kryerjen e kërkimit. Në se dorëshkrimi pranohet për botim ai nuk mund të botohet në të njëjtën formë në një organ tjetër pa marrë leje me shkrim nga IASH.

Punimet duhet të jenë origjinale dhe të kontribuojnë në përparimin e dijes në fushën e caktuar të shkencës. Plagjiatura nuk lejohet dhe do tu raportohet autoriteteve përkatëse. Përfundimet duhet të justifikohen nga skema eksperimentale dhe të dhënat e paraqitura. Informacioni duhet të jetë i qartë dhe i detajuar në mënyrë që të lejojë përsëritjen e punës nga shkencëtarë të tjerë të së njëjtës fushë. Autorët duhet të ruajnë të dhënat ek-

sperimentale dhe t’ja paraqesin këshillit botues të *Akteve* në se ju kërkohet. Shkrimi i punimit duhet të jetë i qartë, konciz dhe korrekt nga ana gramatikore. Autorët mbajnë përgjegjësi për anën shkencore dhe formale të materialeve që paraqesin si dhe për çdo korrespondencë me redaktorët.

ORGANIZIMI I DORËSHKRIMIT

Dorëshkrimi nuk duhet të ketë më shumë se 2500 fjalë duke përfshirë këtu titullin, përmbledhjen, tekstin, bibliografinë, tabelat, grafikët, etj. Dorëshkrimi duhet të shkruhet në Microsoft® Office Word, në formatin A4, me një hapësirë prej 2.5 cm (1 inch) në të gjitha anët, hapësirë dyfishe (double-spaced) midis rreshtave, fonti duhet të jetë Times New Roman me madhësi 12pt. Dorëshkrimi nuk duhet të ketë footnotes apo endnotes. Faqet duhet të numërtohen ndërsa faqja e parë duhet të ketë titullin, emrat, institucionet e autorëve dhe adresat e tyre elektronike.

Dorëshkrimi duhet të përmbajë elementet e paraqitura më poshtë.

1. Titulli – Duhet të jetë sa më konciz dhe i qartë. Emrat e autorëve duhet të kenë adresat e plotë. Mbishkrimet a, b, c mund të përdoren për të përkatësuar autorin me institucionin. Emri i autorit që do të mbajë korrespondencën duhet të ketë një asterisk.

2. Fjalët kyçe – Duhet të paraqiten 4-5 fjalë kyçe të zgjedhura me kujdes që të pasqyrojnë subjektin e punimit.

3. Përmbledhja – Duhet të paraqesë thelbin e punimit dhe përfundimet dhe nuk duhet të jetë më shumë se 150 fjalë. Ajo duhet të paraqitet në dy gjuhë, anglisht dhe shqip.

4. Hyrja – Duhet të përshkruajë shkurt bazën për punën e paraqitur, si dhe punën shkencore të mëparshme të referuar në mënyrë të përshtatshme. Duhet gjithashtu të tregohen objektivat, arsyet e ndërmarrjes së studimit në fjalë dhe rëndësinë e tij praktike.

5. Materialet dhe metoda – Duhet të paraqiten në mënyrë të detajuar materialet dhe procedurat eksperimentale. Informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm që të lejojë përsëritjen e punës prej të tjerëve.

6. Rezultatet dhe diskutimet – Rezultatet duhet të jenë të qarta dhe të ilustruara me tabela dhe grafikë. Rezultatet eksperimentale duhet të analizohen statistikisht dhe të nxirren përfundime në bazë të një besueshmërie statistikore. Implikimet që vijnë nga rezultatet e paraqitura duhet të diskutohen në mënyrë të plotë. Përfundimet duhet të lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e marra. Përfundimet nuk duhet të jenë spekulative dhe të përgjithësohen prej literaturës apo njohurive të përgjithshme e spontane.

7. Bibliografia – Burimet e literaturës duhet të renditen numerikisht në mënyrë alfabetike në bazë të mbiemrit të autorit të parë. Çdo burim literature duhet të referohet në tekst me numrin përkatës. Punimi nuk duhet të ketë më shumë se 20 burime literature. Në se një burim do të citohet ‘në shtyp’ (*in press*) do të thotë se ky punim është pranuar për botim. Dorëshkrimet e papranuara për botim nuk mund të citohen. Gjithashtu nuk pranohen referenca nga interneti me përjashtim të botimeve që bëhen online.

Shembuj të referimit të një artikulli dhe një libri do të jenë si më poshtë:

1. LIBBY W.F., ANDERSON E.C., ARNOLD J.R. (1949) Age determination by radiocarbon content. *Science* 109, 227-228.

2. STRUNK W., WHITE E.B. (1979) *The elements of style*, Third ed. Macmillan, New York

8. Tabelat – Çdo tabelë duhet të paraqitet në një faqe të veçantë. Numri i faqes do të jetë në vazhdimësi të numrit të faqes së fundit ku mbaron bibliografia. Tabelat duhet të kenë numra dhe tituj.

9. Figura ose grafikë – Dorëshkrimi mund të përmbajë figura ose/ dhe grafikë që nuk duhet të jenë përshkrimore. Secila prej tyre duhet të jetë në një faqe të veçantë mbas tabelave. Edhe figurat e grafikët duhet të kenë numra dhe tituj.

Dorëshkrimet nga fushat e shkencave shoqërore mund të mos përmbajnë elementet 5 dhe 6

në mënyrën e paraqitur më sipër. Dorëshkrimet të cilat nuk i përgjigjen formatimit të mësipërm nuk do të merren në konsideratë.

Procedura e pranimit

Dorëshkrimet duhet të dërgohen në adresat e paraqitura më poshtë sipas fushave shkencore përkatëse. Në se fusha e punimit nuk përputhet ekzaktësisht me ndonjë nga fushat e paraqitura me poshtë, dorëshkrimi duhet të dërgohet në adresën e fushës shkencore më të afërt ose te Robert Magarit në adresën: rmagari@hotmail.com

Albanologji (aktet.albanologji@alb-shkenca.org)

Biologji, Biokimi (e njeriut, bimëve, kafshëve)

(aktet.biologji@alb-shkenca.org)

Drejtesi (aktet.drejtesi@alb-shkenca.org)

Ekonomi (aktet.ekonomi@alb-shkenca.org)

Gjeologji, Metalurgji, Inxhinieri Kimike, Riciklim (aktet.gjeometal@alb-shkenca.org)

Inxhinieri Elektrike, Mekanike, Elektronike

(aktet.inxhinieri@alb-shkenca.org)

Kimi, Fizikë, Biokimi

(aktet.kimifizike@alb-shkenca.org)

Matematikë, Statistikë

(aktet.mathstat@alb-shkenca.org)

Mjedis (aktet.mjedis@alb-shkenca.org)

Mjekësi (aktet.mjekesi@alb-shkenca.org)

Prodhimi Bimor

(aktet.prodhimbimor@alb-shkenca.org)

Shkencat Shoqërore

(aktet.shoqeria@alb-shkenca.org)

Teknologji Informacioni dhe Telekomunikacion

(aktet.informacion@alb-shkenca.org)

Tokat Bujqësore (aktet.tokat@alb-shkenca.org)

Dorëshkrimet duhet të dërgohen brenda afatit të caktuar nga këshilli botues. Atij duhet ti bashkëngjitet një mesazh i shkurtër prej autorit drejtuar grupit botues, ku të shprehet dëshira për botimin e punimit, të tregohet pjesëmarrja në takimin vjetor të IASH-së si dhe të specifikohet simpoziumi ku është paraqitur punimi.

Dorëshkrimet do të vlerësohen nga recensentë, identiteti i të cilëve nuk do t’ju zbulohet autorëve. Këshilli botues i revistës do të konsiderojë rekomandimet e recensentëve, do të marrë vendimin përkatës dhe do t’ju komunikojë këtë vendim autorëve brenda një periudhe dy mujore. I gjithë ky proces do të dokumentohet në mënyrë elektronike në arkivin e Institutit Alb-Shkenca.